



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo



AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Dep:	03	Nr. Prot:	
Usp:	DPR	B. Prot:	03-03/1052/20
Orp:		Prot No:	
Nr. Ftag:	03	Data:	28.05.2020
Broj stranica:		Datum:	
Nr. ushper:		Date:	
PRISHTINE			

DATË/A:	27.05.2020
REFERENC-Ë:	AKK- DPKPP /03-03-913/20
PËR/ZA/TO:	z. Agim FEJZULLAHU, Menaxher i Zyrës së Prokurim, Ministria e Punëve të Brendshme
CC:	Znj. Drita HASANI, UD Sekretar i Përgjithshëm i Ministrisë së Punëve të Brendshme
PËRMES/PREKO/THROUGH:	z. Shaip HAVOLLI, Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit
NGA/OD/FROM:	Afrim ATASHI, Drejtor i Departamentit për Parandalimin e Korrupsionit
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Opinion lidhur me Tenderin me titull "Shërbime hoteliere-ushqim dhe pije"

I nderuar z. Fejzullahu,

Në mbështetje të nenit 142 (par. 3) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 5 (par. 1, nënpar. 1.1.) dhe 21 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, nenit 9 (par. 1, nënpar. 1.5.), 16 (par. 2) dhe 21 (par. 3) të Ligjit nr. 06/L-011 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik, nenit 2 par.3 dhe të nenit 10 të Rregullores nr. 01/2018 për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores nr. 01/2014 dhe Rregullores nr. 01/2017, së Punës së Agjencisë kundër Korrupsionit, lidhur me tenderin me titull: "Shërbime hoteliere-ushqim dhe pije" me numër të prokurimit: 214/20/1607/211, dhe me nr. të brendshëm: 214/20/008/211, Agjencia kundër Korrupsionit ofron këtë:

O P I N I O N

Me të cilin kërkohet nga ju si Autoritet kontraktues që t'i ndërmerrni të gjitha veprimet e nevojshme drejt evitimit të shkeljeve të evidentuara në lidhje me tenderin: "Shërbime hoteliere-ushqim dhe pije" me numër të prokurimit: 214/20/1607/211, dhe me nr. të brendshëm: 214/20/008/211, në mënyrë që të respektohen dispozitat përkatëse të Ligjit për prokurimin publik nr.04-L/042 i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin nr.04/L -237, Ligjin nr. 05/L-068 dhe Ligjin nr. 05/L-092.

Arsyetimi

Agjencia kundër Korrupsionit (në tekstin e mëtejme Agjencia), duke vepruar sipas detyrës zyrtare pas kontrollimit të njoftimeve për kontratë që ka bërë në Sistemin elektronik të Prokurimit, me datë 19 maj 2020, ka nxjerrë vendim me numër protokolli: *AKK-03-03-913/20*, për fillimin e procedurës për trajtimin e rastit në lidhje me aktivitetin e prokurimit publik me titull: "**Shërbime hoteliere-ushqim dhe pije**" me numër të prokurimit: 214/20/1607/211, dhe me nr. të brendshëm: 214/20/008/211, i iniciuar nga autoriteti kontraktues Ministria e Punëve të Brendshme.

Agjencia në bazë të dokumenteve të nxjerra nga Sistemi Elektronik i Prokurimit ka analizuar njoftimin për kontratë dhe dosjen e tenderit, ku ka konstatuar se autoriteti kontraktues, për këtë aktivitet të prokurimit ka paraparë procedurën e hapur, kontratë publike kornizë 36 muaj, të llojit shërbime, me vlerë të madhe të parashikuar prej 490,000.00 €.

Në kuadër të rubrikës III.2.4. Kapaciteti teknike dhe profesionale kërkesa 1, Agjencia vëren se, Autoriteti kontraktues *ka kërkuar nga operatorët ekonomik pjesëmarrës të ofrojnë dëshmi se kanë së paku dy (2) kontrata për shërbime të ngjashme hoteliere me ushqim dhe pije, shuma e të cilave duhet të jetë minimum për Lot 1- 250,000.00€, dhe për Lot 2- 350,000.00€, të realizuara në tri vitet e shkuara, para datës së publikimit të këtij njoftim për kontratë.* Kërkesë kjo për të cilën konsiderojmë se bie ndesh me nenin 69 të Ligjit në fuqi për Prokurimin Publik.

Sipas Legjislacioni në fuqi për Prokurim Publik më saktësisht në nenin 69 paragrafi 4.2 parashihet se "Për të vërtetuar aftësitë teknike dhe profesionale të operatorëve ekonomik, autoriteti kontraktues mundet të kërkojë listën me të cilën saktësohen të gjitha kontratat kryesore të rëndësishme të shërbimeve të realizuara në periudhën e shkuar trevjeçare, duke saktësuar llojin e shërbimeve të përfshira, shumën e kontratës, datën dhe pranuesin; (i) kur shërbimet janë siguruar për autoritetin publik në Kosovë ose në vendin tjetër, si dëshmi për këtë sigurim të shërbimeve do të shërbejë kopja e certifikatës (certifikatave) përkatëse të lëshuar ose bashkë nënshkruara nga autoriteti i tillë publik; (ii) kur shërbimet janë siguruar për blerësin privat, dëshmi për këtë sigurim të shërbimeve duhet të jetë kopja e çdo dokumenti të nënshkruar nga blerësi dhe evidentimi i sigurimit të tillë.

Agjencia konsideron se autoriteti kontraktues nuk ka të drejtë të bëjë kufizimin e numrit të kontratave në vlerën e caktuar. E rëndësishme për autoritetin kontraktues është që ta vërtetojë se operatorët ekonomik përmbushin vlerën minimale e cila është kërkuar nga ana e autoritetit kontraktues pavarësisht numrit të kontratave. E jo si në rastin konkret ku është kërkuar numri i kontratave në vlerë të caktuar.

Konsiderojmë se kërkesat e tilla si në rastin konkret e kufizojnë konkurrencën e lirë dhe diskriminojnë operatorët ekonomik të cilët kanë një kapacitet të kënaqshëm ekonomik, teknik-profesional.

Agjenci kundër Korrupsion, konsideron se veprimet e autoritetit kontraktues bien ndesh me nenin 7 Barazia në Trajtim dhe Jo-diskriminimi, si dhe nenin 69 Aftësitë teknike dhe profesionale të Ligjit për Prokurim Publik Nr.04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, dhe nenin 26.8 të Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ për Prokurimin Publik.

Konsiderojmë se shkeljet e tilla nuk duhet lejuar ne aktivitete të prokurimit, andaj Agjencia kundër Korrupsion rekomandon që të evitohen këto shkelje, përmes njoftimit standard për informata shtesë dhe përmirësimin e gabimeve, duke i njoftuar te gjithë operatorët ekonomik të cilët e kanë tërhequr dosjen e tenderit.

Po ashtu ju njoftojmë se lidhur me këto të gjetura do të njoftohet Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik – KRPP.

Autoritetet Kontraktuese e informojnë Agjencinë për veprimet e ndërmarra.

Me respekt !